



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr.60/01-25007/23
Kaçanik 22.09.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, me datën 25.09.2023 (e hënë),do të mbahet mbledhja e VII (të) e rregullt e Komitetit për Komunitete, për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës në sallën e Komiteteve, më fillim pune në ora 14:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Në mbledhjen e VII (shtatë) të Komitetit për Komunitete, të datës 25.09.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Rastet sociale në komunën e Kaçanikut ;
- 3.Të ndryshme.

Ju mirëpresim,

Me respekt!

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 14892/23
Kaçanik, 27.06.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27 qershor 2023 (e martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri – Çaka - PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi - OJQ. Në takim mori pjesë Halim Shehu – Komandant i stacionit policor Kaçanik.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VI -të (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 27 korrik, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ?

Procesverbal i mbledhjes se V (pestë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se V (pestë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 25.05.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-12144/23.

2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut;

z.Halim Shehu: Veprat Penale që kanë dominuar gjatë kësaj periudhe janë 161 raste: Vjedhje 14 ,Vjedhje e rëndë 27, Vjedhje e rënd në tentative 4 ,Vjedhje e shërbimeve 2, Dëmtim në pronë 7, Kanosje 21, Ndotja- degradimi i ambientit 1, Mos ndërmarrja e masave të nevojshme 1, Dhune në familje 8, Ngacmim 4, Ngacmim seksual 1, Falsifikim i parasë 2, Lëndim i lehtë trupor 19 , Lëndim i rënd trupor 3, Lëndim aksidental 1, Ndërhyrje në sistemin kompjuterik 2 , Posedim i paautorizuar i lëndëve narkotike 1, Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm 2, Pengim i personit zyrtarë në kryerjen e detyrës 1, Incident zjarri 3, Zjarreveje 3, Shantazh 2, Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm 2, Shpërdorim i pasurisë së huaj 3, Keqpërdorim i besimit 1, Sulm 3, Vetëgjyqësi 1, Sulm seksual 1, Tentim vrasje 1, Mashtrim 5, Armëbajtje pa leje 9, Asgjësim apo heqje e instalimeve publike 5, Dëmtim i pajisjeve në vendin e punës 2, Uzurpim i paligjshëm i pronës 2, Vrasje 1,Tentim vrasje 1.

z.Arben Thaqi : I sqarojë komandanti shumë mirë, janë shumë gjëra që siguria është me rëndësi edhe në institucione shkollore. Për institucionet shkollore kam një pyetje, ju si polici sa keni mbajtur trajnime me fëmijët ose me nxënësit me qëllim të parandalimit të dukurive negative edhe pse institucionet shkollore arsimore e kanë për detyrë me ju shpjegua në këtë drejtim?

Sa janë të pajisura objektet dhe sheshet e qytetit për me i identifikua këto vjedhje që ndodhin konkretisht vjedhjet e rënda, me qëllim që të kemi një siguri pak më të madhe. Lidhur me posedimin e armëve, a keni ndonjë statistikë apo ndonjë aksion tjetër të grumbullimit të armëve të qytetarët, sepse ky fakt është mjaft shqetësues për faktin armët të cilat përdoren thjesht nuk dihet se kush i përdorë, armë që janë ilegale thjesht me pas një aksion dhe me i konfiskua ato armë të cilat janë parregullta.

z.Halim Shehu: Faktikisht nuk ka asnjë kamerë funksionale, me punët që i kanë kryer komuna në disa rrugë i kanë larguar prej funksionit që nënkupton se aktualisht nuk janë funksionale.

Sa i përket armëve, e ceka edhe me herët janë 11 raste që janë janë konfiskuar, në disa raste ka qenë përdorim me ç'rast kemi pasur informacione dhe disa i kemi zbuluar vet. Aksion për kontrollimin e armëve nuk ka dhe nuk parashihet, mirëpo në momentin që marrim informacion që një person ka një armë do të shkojmë të ja marrim, e thirrjmë në stacionin policorë dhe nëse me vetë dëshirë pranon ta bëjmë bastisjen e shtëpisë nëse jo duhet me marrë leje prej prokurorit dhe duhet patjetër me krye bastisjen, ndërsa aksion për grumbullim armëve nuk ka. Ne e kemi një listë ku i kemi armët e legalizime dhe i mbajmë.

Sa i përket incidentit rreth shkollave policia e Kosovës, në çdo stacion policorë edhe në komunën e Kaçanikut e kemi një grup të zyrtarëve policor që është i trajnuar për policin në komunitet, të cilët mbajnë ligjëratat në çdo shkollë duke përfshirë shkollat e mesme dhe ato fillore, me katër apo pesë tema si: dhuna në familje, ngacmimet seksuale, abuzimet me droga dhe bulëzimi, të cilat tema ne i ligjërojmë d.m.th. policia shkojnë në çdo shkollë dhe i posedojmë të gjitha statistikatat që i kemi zhvilluar këto aktivitete, po ashtu komuna Kaçanikut e mbulon edhe Hanin e Elezit sepse Hani Elezit nuk ka zyrtarë policore të trajnuar për ligjëratat nëpër shkolla.

z.Arben Thaqi : I përmendët rastet e drogës, kjo është një dukuri mjaftë shqetësuese edhe tek fëmijët e në përgjithësi te rinia jonë mirëpo nëse parandalohet dhe vetëdijesohen rreth kësaj dukurie negative është më mirë nëse vazhdon një fenomen i tillë është shqetësuese. Një ashtu është shqetësuese për fëmijët e tonë edhe rrethi ku jetojmë, aty është një gjë që e kam vërejtur ndonjëherë që këta dilerët apo shitësit e substancave narkotike janë të lirë për të vepruar, andaj duhet të punohet më shumë në këtë drejtim. E ceke që zhvilloni ligjërata vazhdimisht në shkolla dhe afërsinë që keni nëpërmjet komunikimeve të shoqëruar me fëmijë edhe përmes aktiviteteve sportive dhe sociale, mirëpo unë mendojë që me ngrite vetëdijen e tyre duhet të ketë më shumë prezencë të policisë nëpër shkolla.

z.Halim Shehu: Me ligj për lëvizje lirë nuk parashihet që policia me kanë shumë prezentë nëpër shkolla, sëpaku nëpër oborre të shkollave nxënëset duhet me pas lirinë e lëvizjes por me kërkesën e drejtorit të shkollës dhe me kërkesën e psikologes, si dhe me kërkesën e zyrtarëve që janë përgjegjës në ndërlidhje mes policisë kemi marrë edhe në shkolla armë, sprej ,thika etj.

z.Arben Thaqi: Këta përdorues është mirë me pas edhe një shoqatë tjetër që merret me këtë çështje, e cila dhe identifikon se kur të identifikohen është më mirë sepse mos mu identifiku është më keq, kur te identifikohen dihet se kush janë edhe dihen rreziqet dhe ku janë rreziqet, nëse nuk ka bashkëpunim me familjen nuk mundesh me zgjedhë një problem, kur prindëri nuk është bashkëpunues dhe nuk pranon asgjë atëherë është problematike zgjedhja e këtij problemi.

z.Ekrem Livoreka: Unë e kam një kërkesë për fshatin Ivajë, Strazhe, Gajre, shkaku i persëve të drunjëve ilegalisht, po e rrezikojnë sigurinë e fëmijve nëpër shkolla dhe banorëve gjatë ikjes nga policia apo rojeve të pyellit, kam një kërkesë që vetëm prezenca e policis mjafton .

z.Halim Shehu: Niveli i bashkëpunimit me qytetarë është shumë i ulët sepse asnjë qytetarë nuk merr iniciativën të deklaroj ndonjë rast si ,psh rastin e dëmtimit të pyellit edhe pse niveli i kofidencialitetit është i sigurt ,qytetarët ende kanë botëkuptimin e asaj që nëse paraqesin raste të tilla gjason me shpijunazh.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 11:50.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**

**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**